SHKOLLA E MESME E QYTETIT TE SHKUPIT SH.M.Q.SH."SARAJ"

Sh.M.Q.Sh "SARAJ"-Shkup



LËNDA: GJUHË PROGRAMORE VITI III

LIBËR PËR Web Programim HTML



Programim në HTML



Profesor : Burim Rexhepi

Dizenjmi Web është krijimi i faqeve Web dhe siteve duke përdorur HTML, CSS, JavaScript dhe gjuhë të tjera Web. Ai është si dizajni në përgjithësi: është kombinimi i vijave, formave, tekstit, dhe ngjyrave për të krijuar një pamje estetikisht të këndshëme. Dizenjmi Web është puna e krijimit të dizajnit për faqet Web.

1. HTML

HTML (Hypertext Markup Language) është një gjuhë shenjash të cilat na lejojnë të shfaqim një përmbajtje të pasur me elementë të ndryshme, tu referohemi burimeve të tjera (sic mund të jenë imazhet, etj.), si dhe të krijojmë lidhje me dokumente të tjera për procesim të mëtejshëm.

HTML përdoret për të krijuar dokumente me strukturë *HyperText*. Një dokument *HyperText* përmban informacion që është i ndërlidhur me dokumente të tjera, duke na lejuar ne të kalojmë nga njëri dokument në tjetrin duke shfrytëzuar të njëjtin aplikacion që po përdornim për të parë dokumentin fillestar.

HTML mund të përdoret gjithashtu për të krijuar dokumente multimediale,p.sh ato që përmbajnë informacion i cili nuk është thjesht tekst si :

Imazhe Tinguj Video Nën programe (plug-ins)

Documentat HTML quhen "Web pages". Browser merr faqet e Web nga Serveri Web që mund të ndodhet kudo në Internet. Për të shkruar HTML mund të përdoren editorët e tekstit si psh NotePad.

HTML është aktualisht në versioni 4.01 dhe vazhdoj të ofroj veçori të avancuara për të krijuar faqe me përmbajtje edhe më të pasur. Është krijuar një specifikim i përputhshëm me HTML, XHTML (Extensible Hypertext Markup Language) e cila përdor sintaksën e XML dhe sjell një XML Schema qe mund te përdoret për te vlerësuar një dokument, për te kontrolluar nëse ai është i krijuar saktë etj. HTML nuk është gjuha e vetme në dispozicion për krijimin e dokumenteve HyperText, ka gjuhë që vinë para dhe pas HTML (SGML, XML, etj), por HTML është bërë gjuha e rekomandimit W3C për krijimin e përmbajtjes për Internetin.

1.1 Bazat e HTML

Dokumentet HTML janë krijuar si dokumente me tekst të thjeshtë (me formatim jo të veçantë) në të cilin i gjithë teksti i formatuar është përcaktuar duke përdorur shenja tekstuale të quajtura *tag-e. Tag-*et janë shenjat tekstuale që fillojnë me karakter <, e ndjekur nga emri i *tag-*ut pasuar me çdo atribut tjetër, dhe në fund mbyllet me karakterin >.

Tag-u hapes do të dukej si me poshtë: *<TAG>*

Fundi i *tag*-ut fillon me karakter <, e ndjekur nga karakteri /, i ndjekur nga emri i *tag*-ut dhe karakteri >. *Tag*-u mbyllës do të dukej si më poshtë: </ *TAG*>

Tag-et janë *case-sensitive*, kuptimi dhe funksioni i tyre ngelet i njëjtë pavarësisht nëse janë shkruar me gërma te mëdha apo me gërma të vogla.

Shembull:
 <title> emri i dokumentit </title>
 <P> Shembull i përdorimit të tag-eve për të shënuar
 tekst </ P>
 Bold<I>Italics</I>Bold

Atributet e *tag*-eve të cilat tregojnë parametrat e tjera vendosen në *tag*et hapëse si më poshtë: <TAG ATRIBUT ATRIBUT...>

Forma e këtyre atributeve shfaqet ose vetëm me emrin e atributit emri i atributit i ndjekur nga =, ndjekur nga vlera që ne duam të caktojmë atë .Për shembull: Lidhëz Në disa raste, në HTML mund edhe të mos i përdorim *tag*-et mbyllës, kjo në rastet ku ato nuk rrethojnë tekst si p.sh rasti i mësipërm i një imazhi.

1.2 Struktura e dokumenteve HTML

<html> <head> <title> vendoset titulli </title> </head> <body> Permbajtja e dokumentit </body> </html>

Të gjitha dokumentet HTML kanë pak a shumë të njëjtën strukturë. I gjithë dokumenti duhet të përfshihet në një *tag* HTML dhe është i ndarë në dy pjesë : pjesa e kokës, e përfshire në një *tag* HEAD dhe trupin e dokumentit (që përmban informacionin e dokumentit), i cili është i përfshirë brenda një *tag*-u të quajtur BODY. Koka përmban disa përkufizime të dokumentit: titullin e tij, shënime shtesë, fjalë kyçe etj. Një shembull mund te jetë:

Titulli i dokumentit

Cdo document HTML ka një titull. Për të caktuar titullin e dokumentit përdoret komanda <title>, psh:

<title>Dokumenti im I pare ne HTML</title>

Titulli vendoset midis tag-ut hapës <title> dhe tagut mbyllës </title>. Titulli vendoset në seksionin e kokës .

Komentet

Në HTML, ne mund të fusim komente në faqe duke e vendosur tekstin brenda *tag*-eve: <-! dhe --!>. Përmbajtja brenda këtyre dy shenjave injorohet nga *browser*-i dhe nuk shfaqet te përdoruesit.

Paragrafët

Tag-u <P> përdoret për të ndarë paragrafët. Meqenëse HTML injoron ndërprerjen e rreshtave të marra nga skedari origjinal dhe i gjithë teksti është i vazhdueshëm për HTML, ne kemi nevojë për një mekanizëm për të treguar fillim dhe fundin e paragrafëve, ky mekanizëm është siguruar nga <P> dhe </P>.

Tag-u P mund të ketë gjithashtu një atribut ALIGN, që tregon drejtimin e tekstit në paragraf. Kjo mund të marre një nga vlerat e mëposhtme:

LEFT, e pozicionuar në të majtë. RIGHT, e pozicionuar në të djathtë. CENTRAL, teksti i qendërzuar

Ndërprerje rreshti

Tag-u
 tregon një ndërprerje rreshti. Ai mund të përdoret si një shenjë fillestare dhe nuk kërkon një *tag* mbyllës. BR nuk do të ndryshojë parametrat e përcaktuara për paragrafin në të cilin ne jemi të vendosur në këtë kohë.

Ndarja e teksteve në blloqe

Elementi <DIV> përdoret për të ndarë tekstin në blloqe duke futur një rresht të vetëm midis blloqeve si BR, edhe pse ai mund të ketë cilësi të njëjta, si P, ne mund të përcaktojmë drejtimin e tekstit për secilin bllok

5

DIV. Parametri ALIGN te DIV merr vlerat e mëposhtme: LEFT RIGHT CENTRAL

Tekst i para-formatuar

Teksti i futur në mes të *tag*-eve <PRE> dhe </ PRE> do të shfaqet nga *browser*-i në përputhje me formatin me të cilin teksti është shkruar duke lënë të pa ndryshuar çdo ndërprerje rresht apo hapësirë.

Në shembullin e mëposhtëm mund të shohim përdorimin e disa prej këtyre *tag*-eve:

<HTMT.> <HEAD> <TITLE>Rreth Shqipërisë </TITLE> </HEAD> <BODY> <P ALIGN=LEFT> Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28.748 km2. Ajo është pozicionuar në pjesën jug perëndimore е të qadishullit Ballkanit dhe kufizohet në veri me Malin e në verilindje me Kosovën, në lindje Zi, me Maqedoninë dhe në jug e jug -lindje me Greqinë. Në laget nga ujërat e deteve Adriatik perëndim vendi Jon. Shqipëria ndahet në katër zona dhe fiziko _ gjeografike (Alpet e Shqipërisë, Krahina Malore Qëndrore, Krahina Malore Jugore dhe Ultësira Perëndimore). </P> <DIV ALIGN=RIGHT> Klima e Shqipërisë është tipike mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër relativisht të butë brendësi dhe të lagët. Në pjesët malore, në të vendit veçanërisht në veri, dimri është i ashpër dhe me dëborë, ndërsa vera është e freskët me temperaturë të këndshme. </DIV> <DIV ALIGN=CENTER> Shqipëria është në përgjithësi vend malor. Malet dhe kodrat zënë 2/3 e sipërfaqes. Maja më e lartë e vendit është Korabi 2.763 m, në rrethin e Dibrës në veri - lindje të vendit. Ultësirat të cilat zënë 1/3 e sipërfaqes shtrihen përgjatë bregdetit Adriatik si dhe në zonën e Korçës në juq - lindje të vendit. </DIV> <PRE>

Lumenjtë kryesorë janë: Drini, Vjosa, Shkumbini, Semani, Mati, Buna. Prej tyre vetëm Buna, në rrjedhën e poshtme është i lundrueshëm. Më shumë se një treta e Shqipërisë është e mbuluar nga pyje. Një e е treta është kullotë dhe vetëm rreth një e pesta është e kultivuar. </PRE> <CENTER> <P> Shqipëria ka një pozicion mjaft të përshtatshë gjeografik për zhvillimin e industrisë turistike me akses mjaft të volitshëm ndaj tregjeve kryesore evropiane, me një potencial klimaterik shumë të favorshëm, me një shtrirje të gjatë plazhesh ende pastra, dhe me male të lartë dhe liqene të shumtë mëdhenj e të veqjël.. </P> </CENTER> </BODY> </HTML>



1.3 Fontet

HTML përmban edhe *tag*-e për ndryshimin e atributeve te teksteve tona si fontin dhe ngjyrën.

Headers

Ekziston një element i quajtur <Hx> që në HTML mund ta përdorim për te përcaktuar pjesët e tekstit që duam ti konsiderojmë si *headers* (seksione,kapituj etj). Ky *tag* i cakton një madhësi më të madhe tekstit (në bazë të x, siç do ta shohim), e bën atë më të nxirë (*bold*) si dhe vendos fillimin e një paragrafi mbas këtij *header*-i.

Madhësia e *header* mund të ndryshojnë nga 1në 6 dhe kemi 6 *tag*-e të mundshme: H1, H2, H3, H4, H5 dhe H6.

Font-et

Në HTML përdoret *tag*-u FONT për ti dhënë tekstit stile, ngjyra dhe efekte të ndryshme të cilat bëjnë që ai të duket më i këndshëm kur të afishohet në faqen tonë të web-it. Në HTML 4.01 ky *tag* nuk përdoret dhe funksioni i tij zëvendësohet duke përdorur CSS te cilën do ta studiojmë në vazhdim.

Font styles

HTML ofron një sërë *tag*-esh të cilat mund të përdoren për ti vendosur stile të ndryshme tekstit që ndodhet brenda këtyre *tag*-eve. Disa prej tyre janë:

B (bold). I (italics). U (underlined). STRIKE (strikethrough). SUP (superscript). SUB (subscript). BLINK TT (teletype). BIG (big). SMALL (small).

Në HTML, ne mund ti vendosim tekstit edhe disa stile njëkohësisht si mund të jetë *bold* dhe *italic* si më poshtë:

8

<I>Tekst me dy stile të ndryshme.</I>

Më poshtë është paraqitur një shembull i cili ilustron përdorimin e stileve te sipërpërmendura.

```
<HEAD>
<TITLE> Titulli i dokumentit</TITLE>
</HEAD>
<BODY>
<h1>Header H1</h1>
<h2>Header H2</h2>
<h3>Header H3</h3>
<h4>Header H4</h4>
<h5>Header H5</h5>
<h6>Header H6</h6>
<b>Font size</b> <BR>
<font SIZE=1>1</font> <font
SIZE=2>2</font> <font SIZE=3>3</font>
<font SIZE=4>4</font> <font</pre>
SIZE=5>5</font> <font SIZE=6>6</font>
<font SIZE=7>7</font> <font</pre>
SIZE=6>6</font> <font SIZE=5>5</font>
<font SIZE=4>4</font> <font
SIZE=3>3</font> <font SIZE=2>2</font>
<font SIZE=1>1</font>
<P>
<B>Colours</b>
<font COLOR=#800000>C</font><font</pre>
COLOR=#000080>O</font>
<font COLOR=#000080>L</font><font</pre>
COLOR=#008000>0</font>
<font COLOR=#00FFFF>R</font><font
COLOR=#FF0000>E</font>
<font COLOR=#C0C0C0>S</font> . <font</pre>
COLOR=#800080>D</font>
<font COLOR=#008080>E</font> . <font</pre>
COLOR=#FF0000>L</font>
<font COLOR=#808080>E</font><font
COLOR=#FF00FF>T</font>
<font COLOR=#00FF00>R</font><font</pre>
COLOR=#808000>A</font>
<font COLOR=#FFFF00>S </font>
<b>Bold</b> <br> <i>Italics</i>
<br> <u>Underlined</u><br>
```

```
<strike>Strikethrough</strike> <br>
A<sup>Superscript</sup> <br>
B<sub>Subscript</sub><br>
<blidhëz>Blidhëzing</blidhëz> <br>
<tt>Typewriter(Teletype)</tt> <BR> <big>Big
text</big> <br> <small>Small text</small>
</BODY>
</HTML>
```

Më poshtë jepet rezultati që shfaqet në *browser* pas ekzekutimit të kodit te mësipërm.

Header H1 Header H2 Header H3 Header H4 Header H5 Header H6 Font 1234567654321 Colours CO LO RE S. D E. L ET RA S Bold **Italics** Underlined Strikethrough ASuperscript BSubscript Blidhëzing Typewriter(Teletype) Big Small text

size

text

Vendosja e karaktereve të veçanta

HTML përdor disa kode të veçanta për të mundësuar shtypjen e karaktereve të cilat nuk i shkruajmë dot nga tastiera. Tabela e mëposhtme paraqet kodet dhe simbolin që ato përfaqësojnë.

| Kodi | Rezultati |
|---------|-------------|
| á, Á, é | ;, á,Á,é,É, |
| É, | |
| ¿ | |
| ¡ | |
| º | |
| ª | |
| ™ or ™ | |
| © | |
| ® | |
| | |
| < | |
| > | |
| & | |
| " | |

1.4 Linket

Një nga tiparet kyçe të Web-it, e cila e ka bërë dhe më të suksesshëm atë, është lidhja ndërmjet dokumenteve të cilat ndodhen në servera të ndryshëm. Lidhja mund të bëhet me imazhe, audio, video si dhe me faqe web-i të tjera. Lidhjet mund të krijohen duke përdorur *tag*-un A dhe atributet e tijë NAME, HREF, TARGET.

Nëse lidhëza bën lidhjen e faqes me një faqe tjetër, ku kjo e fundit është pjesë e të njëjtit site atëherë lidhëza njihet si linke brendshme. Nëse lidhëza ju lidh me një faqe të re, por te site tjetër atëherë lidhëza njihet si linke jashtme. Gjithashtu mund të krijojmë një linke cila të na çoj në një pjese tjetër të së njëjtës faqe.

Një link specifikohet me anë të *tag*-ut <a>. Çdo gjë që shkruhet midis *tag*-ut hapës <a> dhe *tag*-ut mbyllës do të jetë pjesë e lidhëzës e cila pasi klikohet nga përdoruesi do të kaloj në faqen e re.

Linket në njëfaqe te re WEB

Për të lidhur një faqe me një faqe tjetër nevojitet që *tag*-u hapës <a> të përmbaj atributin *href* dhe vlera e atributit është emri i skedarit për tek i cili nevojitet të kalojmë. Një shembull mund të jetë:

11

<body> Kthehu tek Shembulli pare </body>

Nevojitet që të dy skedarët (fshembulli1.html dhe shembull2.html) të gjenden në të njëjtën dosje. Kur të klikojmë mbi link <u>Linku qe un</u> <u>krijova</u>do të hapet faqja shembull1.html në të njëjtën dritare.

i

Nëse duam të kalojmë në një faqe të re të një site tjetër përsëri do të përdorim elementin <a> dhe atributin *href* por kësaj here duhet që si vlerë të atributit href të vendosim URL-në e plotë faqes ku duam të shkojmë. Si p.sh :

```
<body>
  A doni te vizitoni <a
href="http://www.uamd.edu.al/">faqen e
UAMD- se</a>?
</body>
```

Kur të krijoni lidhëza kini parasysh që të përdorni fjalë të cilat përkufizojnë në mënyrë sa më koncize faqen ku ju do të drejtoheni. Nga ana tjetër për të ndihmuar përdoruesin nga ana vizuale këshillohet që linket të ngjyrosen në mënyrë që të bëhen më të dukshme midis fjalëve të tjera të përmbajtjes së faqes.

Shumë dizenjues të web-it përdorin imazhet brenda elementit $\langle a \rangle$. Në rast se përdorni figurat duhet që ajo të jetë shpjeguese e mirë e faqes tek e cila të drejton.

Brenda elementit <a> mund të përdoret edhe atributi *title* dhe vlera e tij do të jetë shpjegimi që ju doni të shfaqet në rastin se afrojmë mousin mbi lidhëz. Ky trik është i vlefshëm sidomos në rastet kur lidhëza është figurë.

Kështu p.sh. shtojmë në shembullin tonë rreshtat e mëposhtëm:

```
<a href=http://www.google.com/ title="Kerkimi ne
Google"> Google </a> eshte nje motor kerkimi
shume i fuqishem.
```

Lidhja e adresave email

Në disa raste kemi parë që në faqe shfaqen adresat e personave të ndryshëm dhe pasi klikoni mbi to hapet një dritare e cila jep mundësin e dërgimit të një emaili adresës së sapo klikuar.

Për të krijuar një link mbi një adresë email-i duhet të shtoni atributin *href* i cili si vlerë duhet të ketë:

emer@shembull.com

1.5 Listat

Në HTML kemi dy lloje listash:

Unordered list që janë në formën e pikave të plota të mbushura Ordered list që janë një sekuencë me numra apo shkronja

```
Shembull i listave te parenditura
<html>
<body>
<h4>List e parenditur:</h4>

Kafe
Caj
Qumesht
</body>
</html>
```

List e parenditur:

- Kafe
- Caj
- Qumesht

```
Shembull i listave te renditura
```

```
<html>
<body>
<h4>Liste e renditur:</h4>
Kafe
Caj
</body>
</html>
```

| Liste e renditur: | |
|--|--|
| Kafe Caj Qumesht | |

```
Shembull i listave te nderthuruara
<html>
<body>
<h4>List e nderthurura:</h4>
Kafe
 Caj
  Caj i Zi
  Caj Jeshil
   Qumesht
</body>
</html>
```

| List e | List e nderthurura: | | |
|--------|--------------------------------|--|--|
| : | Kafe Caj | | |
| | Caj i Zi | | |
| | Caj Jeshil | | |
| • | Qumesht | | |
| | | | |

1.5 Imazhet

Për të vendosur imazhet ose grafikët në një faqe Web përdoret një *tag* i vetëm i quajtur . ka disa atribute të cilat përcaktojnë se cilin skedar imazhi do të përdorim, madhësinë e tij etj. Atributi i cili përcakton imazhin që do të shfaqet është SRC. Me anë të këtij *tag*-u ne mund të përcaktojmë një URL për skedarin e imazhit që do të kërkohet në server për tu paraqitur në browser. Imazhi mund te jetë i ruajtur në çfarëdo direktorie mjafton që vlera që ne do ti japim *tag*-ut SRC të jetë një URL.

Nëse duam që ti shtojmë një tekst imazhit tonë përdorim atributin ALT.

Atributet WIDTH dhe HEIGHT përdoren për të përcaktuar përmasat me të cilat duam që të shfaqet imazhi në faqen e Web-it. Nëse ne nuk i përcaktojmë këto përmasa, browseri do ta shfaqi imazhin me përmasat qe ka vetë imazhi.



Ky imazh do të shfaqej në browser më anë të kodit të mëposhtëm.

```
<hrpre><HTML>
<HEAD>
<TITLE>Document title</TITLE>
</HEAD>
<BODY>
<IMG SRC="html.jpg"> <P>
</BODY>
</HTML>
```

Imazhet mund të krijohen në mënyra dhe formate të ndryshme. Browseri njeh formatet GIF, JPEG dhe PNG. Për të shmangur mungesat është mirë të mos përdorim imazhe shumë të mëdha.

Ushtrime

- 1. Ndërtoni një faqe web e cila të përmbajë tekstet si më poshtë: emrin tuaj me ngjyrë jeshile dhe font Tahoma. Një paragraph me 4-5 fjali ku secila prej tyre ka një formatim ndryshe.
- Ndërtoni nje faqe web e cila afishon përshkrimin e një libri, sipër përshkrimit ndodhet titulli I librit I cili është I nënvijëzuar dhe me tekst të theksuar. Në fund të përshkrimit vendosni një imazh I cili përfaqëson kapaku i librit.
- 3. Afishoni në një faqe web një imazh I cili ka një border me madhësi 2, gjerësi dhe lartësi 200.
- 4. Ndërtoni një faqe web ku të ruani profilin Tuaj në formën e një CV të shkurtuar. Vendosni aty një foto Tuajën. Përdorni headings dhe paragrafët. Përdorni, tagun <a> për të krijuar lidhje me profilin Tuaj në facebook apo linked in. Përdorni listat për të ilustruar njohuritë Tuaja kompjuterike dhe të gjuhëve të huaja (gjuha, sqarimi, p.sh anglisht, shumë mirë , si në llojin e tretë të listave).

2. Tabelat

HTML ka një grup *tag*-esh te cilat përdoren për të paraqitur tekstin në formën e një tabele. Këto *tag*-e janë:

- TABLE: shënon fillimin dhe mbarimin e një tabele
- TR: shënon fillimin dhe mbarimin e një rreshti
- TH: shënon fillimin dhe mbarimin e një qelize ne kokën e tabelës
- TD: shënon fillimin dhe mbarimin e një qelize
- CAPTION: përdoret për ti vendosur tabelës një titull

```
Kodi për një tabelë të thjeshtë do të ishte:
<TABLE>
<TR><TH>Header 1</TH>...<TH>Header
n</TH></TR> <TR><TD>Cell 1.1</TD>...<TD>Cell
n</TD></TR> ...
<TR><TD>Cell 1.1</TD>...<TD>Cell n</TD></TR>
<CAPTION>Title</CAPTION>
</TABLE>
```

Sic mund të shohim në pjesën e kodit tabela vendoset brenda *tag*-eve TABLE. Çdo rresht duhet të vendoset brenda *tag*-eve <TR> dhe </TR>. Për të paraqitur qeliza të veçanta kemi dy mundësi: duke përdorur *tag*-un <TH> ose <TD>. Dallimi është se mundësia e parë përdor tekst *bold* dhe e qendërzon kolonën.

Tag-u TABLE ka disa atribute të cilat shërbejnë për ti dhënë tabelës formatin që na nevojitet.

• BORDER: përcakton madhësin e konturit të qelizës.

• CELLSPACING: përcakton madhësin në pika të hapësirës ndërmjet qelizave.

• CELLPADDING: përcakton distancën në pika ndërmjet përmbajtjes së një qelize dhe borderit të sajë.

• WIDTH: specifikon gjerësin e tabelës, mund të paraqitet me pika ose ne përqindje duke u bazuar në raportin që ajo ka me gjerësin totale.P.sh100% përfaqson gjerësin e të gjithë dritares së browserit.

• ALIGN: pozicionon tabelën në lidhje me faqen, në të majtë(LEFT), në të djatëherëte (RIGHT) ose në qendër (CENTER).

• BGCOLOR: përcakton ngjyrën e tabelës.

Shembull tabele në të cilën përfshihen edhe atributet e mësipërme:

| 1.1 dhe 1.2 | | 1.3 |
|-------------|-----|-----|
| 2.1 dhe 3.1 | 2.2 | 2.3 |
| | 3.2 | 3.3 |

Tabele e Thjeshte

Tabele me ngjyra dhe imazh

| css | Maj | Qershor | Korrik | Gusht |
|-----|-------|---------|--------|-------|
| | 22 | 23 | 3 | 29 |
| | 1234 | 1537 | 7 | 1930 |
| | 11000 | 13000 | -500 | 60930 |

```
<HTML>
<HEAD>
<TITLE>Document title</TITLE>
</HEAD>
<BODY>
<TABLE BORDER=1>
<TR>
<TD COLSPAN=2>1.1 dhe 1.2</TD>
<TD>1.3</TD>
</TR>
<TR>
<TD ROWSPAN=2>2.1 dhe 3.1</TD>
<TD>2.2</TD>
<TD>2.3</TD>
</TR>
<TR>
<TD>3.2</TD>
<TD>3.3</TD>
</TR>
```

•

```
<CAPTION ALIGN=bottom><strong><br>Tabele
e Thjeshte</strong></CAPTION>
</TABLE>
<strong>Tabele me ngjyra dhe
imazh</strong> <TABLE BORDER=0 CELLSPACING=0</pre>
BGCOLOR=#0000FF>
<TR><TD>
<TABLE BORDER=0 CELLSPACING=1 CELLPADDING=2
WIDTH=400 BGCOLOR=#FFFFFF>
<TR>
<TH><IMG SRC="css logo.png" height="53"></TH>
<TH>Maj</TH>
<TH>Oershor</TH>
<TH>Korrik</TH>
<TH>Gusht</TH>
</TR>
<TR>
                                            <TD
BGCOLOR=#A0A0A0> </TD>
<TD>22</TD>
<TD>23</TD>
<TD>3</TD>
<TD>29</TD>
</\mathrm{TR}>
<TR>
<TD BGCOLOR=#A0A0A0>&nbsp;</TD>
<TD>1234</TD>
<TD>1537</TD>
                                            <TD
BGCOLOR=#FFa0a0>7</TD>
<TD>1930</TD>
</TR>
<TR>
<TD BGCOLOR=#A0A0A0>&nbsp;</TD>
<TD>11000</TD>
<TD>13000</TD>
<TD BGCOLOR=#FF4040>-500</TD>
<TD BGCOLOR=#a0a0FF>60930</TD>
</TR>
</TABLE>
</TD></TR>
</TABLE>
</BODY>
</HTML>
```

thead, tfoot, dhe tbody

Tag-u <thead> përdoret për të grupuar përmbajtjen e headerit të një tabele HTML. Elementi thead duhet të përdoret bashkë me elementët tbody dhe tfoot.

Elementi tbody përdoret për të grupuar përmbajtjen e body në një tabelë HTML dhe tag-u tfoot përdoret për të grupuar përmbajtjen e footer-it.

Në një tabelë tag-u <tfoot> duhet të shfaqet para në mënyrë që një browser të mund shfaqë footer-in përpara se të marrë të dhënat e të gjithë rreshtave.

Shembull i përdorimit të tag-eve thead, tfoot, dhe tbody:

```
<thead>
 Month
  Savings
 </thead>
<tfoot>
 Sum
  $180
 </tfoot>
January
  $100
 February
  $80
```

2.1 Dizenjimi ifaqes nëpërmjet tabelave

Tabelat në website janë përdorur për dy arsye :

- Për të organizuar dhe shfaqur informacionin në formën e një tabele, kur një gjë e tillë është e nevojshme.
- Për të krijuar layoutet e një faqe duke përdorur tabelat e fshehura.
- Përdorimi i tabelave për të ndarë një faqe në seksione të ndryshme është një mjet shumë i fuqishëm. Kryesishtë në lidhje me layoutet, tabelat përdoren për të funksionet e mëposhtme:
- Për të ndarë faqen në seksione të ndryshme Për të krijuar menu, zakonishtë përdoret një ngjyrë për pjesën header dhe një tjetër për rreshtin tjetër ku gjenden linket.
- Për të shtuar fusha formash interactive. P.sh opsionin e kërkimit.
- Krijohen header të cilët ngakohen më shpejt.
- Pozicionim më i lehtë i imazheve të cilat janë ndarë në copa të vogla.
- Një menyrë më e lehtë për ta shfaqur tekstin në kolona. Analizojmë një faqe në web. P.sh. moh.gov.al e cila ka pamjen e mëposhtme:

Vëmë re që është një bashkësi tabelash brenda njëra tjetrës. Tabela e madhe ka gjerësi fikse për efeket design.

Ushtrime

- 1. Ndërtoni një faqe të thjeshtë HTML e cila përmban një një tabelë që paraqet orarin tuaj javor. Çdo kolonë e cila përfaqëson edhe ditët e javës të shfaqet me një ngjyre të ndryshme.
- 2. Ndërtoni një faqe HTML layout-i i të cilës është ndërtuar me anë të një tabele me tre rreshta ku rreshti i parë përfaqëson header-in e faqes dhe brenda tij vendoset një imazh në formën e banerit. Rreshti i dytë, trupi i faqes, është i ndarë në tre kolona ku në kolonën e parë kemi të paraqitur me anë të listave katër herë fjalën "menu1". Kjo përfaqson menunë vertikale. Në rreshtin e tretë vendosni "Copyright" e cila përfaqson footer-in e faqes.

3. Format

Format janë elementë HTML të cilat përdoren për të marrë informacion nga përdoruesi. Një form mund të përmbajë elementë inputi të tilla si fusha teksti, checkboxe, radio-buttona, butona submit etj.

Një mënyrë për të krijuar një formë është kjo:

<FORM ACTION="url process" METHOD="POST"> ... Elements ... </FORM>

Atributet e Formave

• ACTION: ky atribut përcakton URL-në ku do të dërgohen të dhënat që do të shtypi përdoruesi. Atributi action tregon se cfarë i ndodh të dhënave kur shtypet butoni i dërgimit. Zakonisht vlera e atributit është një faqe ose një program në një web server që do të marrë dhe procesoj të dhënat e dërguara.

Për shembull, nqs keni një form logimi që kërkon një username dhe një password; këto të dhëna që fut përdoruesi do të kalojnë në një faqe login.php dhe në këtë rast vlera e atributit action i faqes sonë do të jetë <form action="http://www.siteJuaj.org/login.php">. Si URL mund të përdoret një adresë emaili p.sh: mailto:address@e.mail ose një HTTP URL http://www.uamd.edu/form.html.

•METHOD: metoda përcakton mënyrën se si të dhënat do të dërgohen. Ekzistojnë dy mundësi GET dhe POST. Metoda get i dërgon të dhënat si pjesë të URL. Metoda post i fsheh të dhënat në dicka të njohur si pjesë të headerit HTTP.

• ENCTYPE: përcakton tipin e kodimit të përdorur.

Atributi id

Atributi id ju lejon ju të identifikohen në mënyrë unike elementët brenda një elementi <form> ashtu sic ju identifikoni në mënyrë unike një element në një faqe.

Është praktikë e mirë që ju ti specifikoni një element id cdo elementi formë sepse shumë forma përdorin file për style dhe skripte të cilët kërkojne përdorimin e atributit id në mënyre që të bëhet dallimi i tyre.

Vlera e atributit id duhet të jetë unike brenda një dokumenti. Disa persona vendosin si vlerë te atributit id dhe name për formën karakteret frm dhe më pas përshkruajne të dhënat si psh në rast të një formë logimi përdoret frmLogin apo në rast të një forme kërkimi frmKërkim etj.

Atributi name (deprecated)

Ashtu sic e kemi parë tashmë përdorimin e këtij atributi nëpër elementë të tjerë, atributi name është paraardhësi i atributit id dhe vlera e tij duhet të jetë unike në të gjithë dokumentin.

Në mënyrë përgjithësuse nuk do të shihni përdorim të atributit name porse nqs do tju duhet ta përdorni ath këshillohet që si vlerë të tij të vendosni vlerën që keni vendosur për atributin id. E ngjashme me atributin id keshillohet që si vlerë tek value të vendosni frm_qëllimiFormës si psh frmKërkimi apo frmLogimi.

3.1 Elementet e Formës

HTML ofron një gamë të gjerë elementësh që përdoren për input në forma. Ato mund të përdoren për funksione të ndryshme si për shkruajtur tekst apo për dërgim skedarësh.

<INPUT>

Elementi INPUT është më i përdoruri dhe përdoret si një fushe për të marrë te dhëna. Ekzistojnë disa lloje të ndryshme të elementit INPUT në varësi te vlerës që merr atributi TYPE:

• TYPE=RADIO: lejon që të zgjedhin nga një rang mundësish, por vetëm një në një kohe.

• TYPE=RESET: fshin të gjithë formën.

• TYPE=TEXT: i lejon përdoruesit që të fus një rresht tekst.

• TYPE=PASSWORD: i lejon përdoruesit që të fus një rresht tekst i cili paraqitet si

"*" në vend të tekstit. Zakonisht përdoret për pjesën ku do të shkruhet password-i.

• TYPE=CHECKBOX: na lejon të zgjedhim një ose më shumë opsione.

•TYPE=SUBMIT: merr të dhënat e futura në formë dhe kryen veprimin e caktuar.

• TYPE=HIDDEN: një fushë teksti e cila nuk i shfaqet përdoruesit. Përdoret për të ruajtur vlera.

Elementi INPUT ka edhe disa atribute opsionale:

• NAME: emërton fushën. Kjo është e rëndësishme për tu përdorur në kod për përpunime të tjera.

• VALUE: i vendos një vlerë fillestare fushës.

SELECT

SELECT përdoret për të zgjedhur një ose më shumë nga opsionet e mundshme.

Një shembull do të ishte:

<SELECT name="destination">

<option> Africa <option> Antarctica <option> America <option> Asia <option> Europe

<option> Oceania

</SELECT>

Atributet e elementit SELECT janë:

• SIZE: Nëse SIZE ka vlerën 1, vetëm një nga opsionet do të shfaqet, nëse vlera është më e madhe se 1 përdoruesit do ti shfaqet një listë me zgjedhje.

•MULTIPLE: përdoruesit mund të zgjedhin më shumë se një opsion, nëse kjo është e zgjedhur.

Elementi OPTION ka dy atribute:

•VALUE: vlera që do ti caktohet variabëlit kur te jete zgjedhur ky opsion.

• SELECTED: ky opsion zgjidhet vetvetiu.

TEXTAREA

TEXTAREA përdoret për të marrë nga përdoruesi disa rreshta tekst. Formati i sajë është si më poshtë:

<TEXTAREA name="comments" cols=30 rows=6> Jepni përshtypjet tuaja rreth faqes tonë! </TEXTAREA>

Përmbajtja që vendoset ndërmjet <TEXTAREA> dhe </TEXTAREA>
përbën vlerën fillestare të kësaj fushe.
Atributet e TEXTAREA janë:
ROWS: rreshtat që do të merren nga kutia e tekstit.

- COLC 1 1
- COLS: kolonat.

Tani do të shohim një shembull i cili përdor elementet qe pamë në këtë pjesë.

| 🌈 Document title | |
|--|--|
| Test | |
| Emer: | |
| Mbiemer: | |
| Password: | |
| Gjinix Mashkull © Femer Hobi: Sporti © Muzika © Leximi Origjina: Albania • | |
| Ku do te doje te udhetoje: Albania ^ Antarctica Antarctica Antarcia Azia * Oninioni juaj: | |
| Shkruani ate qe * * | |
| Submit Query Reset | |
| lone | |

Kodi HTML nga i cili kemi marrë rezultatin e mësipërm është:

```
<HTML>
<HEAD>
<TITLE>Titulli i Dokumentit</TITLE>
```

```
</HEAD>
<BODY>
<H1>Test</H1>
<FORM METHOD=GET>
Emer: <INPUT TYPE=TEXT NAME=NAME SIZE=10><BR>
Mbiemer: <INPUT TYPE=TEXT NAME=SURNAME SIZE=30><BR>
Password:
             <INPUT
                         TYPE=PASSWORD
                                            NAME=PASS
SIZE=8><BR>
<HR>
Gjinia: <BR>
<INPUT TYPE="RADIO" NAME="Gender">Mashkull
<INPUT TYPE="RADIO" NAME="SEXO">Femer
<BR>
Hobi:<BR>
<INPUT TYPE="CHECKBOX" NAME="SPORT">Sporti
<INPUT TYPE="CHECKBOX" NAME="MUSICA">Muzika
<INPUT TYPE="CHECKBOX" NAME="LECTURA">Leximi <BR>
Origjina:<BR>
<SELECT name="ORIGIN">
<option> Albania
<option> Antarctica
<option> America
<option> Asia
<option> Europe
<option> Oceania
</SELECT>
<HR>
Ku do te doje te udhetoje:<BR>
<SELECT name="destination" MULTIPLE</pre>
SIZE=4> <option> Albania
<option> Antarctica
<option> America
<option> Asia
<option> Europe
<option> Oceania
</SELECT>
<BR>
Oninioni juaj:
<BR>
<TEXTAREA COLS=20 ROWS=6 NAME="YOUR
OPINION"> Shkruani atë qe mendoni!
</TEXTAREA>
<HR>
```

```
<INPUT TYPE=SUBMIT> <INPUT TYPE=RESET>
</FORM>
</BODY>
</HTML>
```

Butonat

Butonat përdoren në rastet më të shpeshta për të dërguar të dhënat e një forme, si dhe nganjëherë për të pastruar të dhënat nga një formë. Ju mund të krijoni butona në tre mënyra:

Duke përdorur elementin *<input>* me atributin *type* vlera e të cilit është *submit*, *reset* ose *button*.

Krijimi i butonit duke përdorur elementin <input>

Kur ju përdorni elementin <input> për të krijuar një buton, tipi I butonit që ju krijoni specifikohet në atributin type. Atributi type mund të marrë vlerat e mëposhtme për të krijuar butonin:

Submit, I cili krijon një buton që dërgon të dhënat e formës

Reset, I cili krijon një buton që në mënyrë automatike bën boshatisjen e kontrolleve të formës nga vlerat tyre inicializuese qe plotësohen gjatë shkarkimit të faqes.

Button, i cili krijon një buton që përdoret për të startuar një script të anës klient kur përdoruesi klikon mbi një buton.

Ushtrime

Ndërtoni një faqe të thjeshtë në të cilën të vendosni dy textbox-e në të cilat ti kërkoni përdoruesit emrin dhe mbiemrin. Emërtojeni faqen revista.html.

Në faqen revista.html të cilën e krijuat në ushtrimin e parë, shtoni disa fusha të tjera të cilat duhet ti plotësojë përdoruesi si adresa, qyteti, shteti, kodi zip.

Duke supozuar që kjo faqe do të shërbejë për abonimin në një revistë, shtoni një dropdown list me pesë emra revistash të njohura si dhe dy radio buttona me anë të të cilave ne zgjedhim abonim nje vjecar apo dy vjecar.

Shtoni një tekstbox në të cilin abonuesi të lërë komentet e tijë. Faqja do të duket si më poshtë:

| Name: | | | |
|----------------|----------|---------|--|
| Address: | | | |
| City: | | | |
| State: | | | |
| Zip: | | | |
| Magazine: | Newsweek | • | |
| Subscription: | I year | 2 years | |
| Additional Cor | nments: | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Send Your Order

4. CSS

CSS qëndron për Cascading Style Sheets. Stilet përcaktojn si do të paraqiten elementet HTML. Kjo realizohet duke i bashkangjitur atribute prezantimi në çdo element HTML ose nënklasë të sajë. Për shembull nëse ne duam që të gjithë paragrafët të kenë një background me ngjyrë të kuqe dhe tekst me ngjyrë të verdhë, do të përdornim kodin e mëposhtëm:

```
<STYLE TYPE="text/css"> P {color: red;
background:yellow;} </STYLE>
```

Nëse duam të përcaktojmë stilet që do të përdoren në një faqe përdorim *tag*-un STYLE, ndërsa *tag*-u LINK shërben për të treguar skedarin e jashtëm i cili mban stilet që do të përdorim ne në faqe. *Tag*-u STYLE duhet të vendoset në kokën e faqes.

Parametri TYPE përdoret për të treguar sintaksën që do të përdorim për të përcaktuar stilet, në rastin tonë ne do të përdorim text/css. *Tag*-u LINK përdoret si më poshtë:

<LINK REL="stylesheet" HREF="miweb.css" TYPE="text/css">

Stilet ruhen zakonisht në një skedar të jashtëm me prapashtesën .css. Stilet e ruajtura jashtë bëjnë të mundur që ju të ndryshoni pamjen e të gjitha faqeve të një Web siti duke edituar një skedar të vetëm.

Formati i Style sheet Sic pamë edhe më lartë formati i një style sheets është si më poshtë: <element>{<format>}

Per shembull:
P {color: red; background:yellow;}

Sintaksa e CSS është case sensitive. Kjo sintaks na lejon që të përcaktojm formatin që duam të kemi në paragrafët e website-it tonë. Në HTML 4.0 është shtuar një atribut CLASS i cili na mundëson krjimin e klasave elementësh tek të cilat do të zbatohet stili.

Për shembull për të përcaktuar një klas paragrafi të cilën e emërtojm *iformatuar* do të shkruanim:

```
P. iformatuar {color: red; background:yellow;}
<P CLASS=" iformatuar ">Paragraf i
formatuar.</P> <P>Paragraf normal</P>
```

Ekziston edhe një metodë për caktimin e një stili të veçantë paragrafëve të veçanta. Për ketë duhet të përcaktojmë stilin e elementëve të HTML me anë të CSS duke përdorur sintaksën e mëposhtme:

#paragraph1 {color: green; background:yellow;}
Këto identitete mund tja bashkëngjisim një
elementi HTML duke perdorur atributin ID.
Nje paragraf i theksuar</P>
<P>Paragraf normal</P>
<P CLASS="highlighted" ID="paragraph1">Paragraf
i theksuar por duke perdorur atributin ID</P>

4.1 SPAN dhe DIV

Më parë, pamë se si të caktojmë stile të elementëve të HTML, por ne ndonjëherë duam të caktojmë stile në seksione të tekstit ose përmbajtje që nuk janë pjesë e një blloku HTML. Kjo realizohet me anë te *tag*-eve DIV dhe SPAN.

Nëse duam të etiketojmë një pjesë të përmbajtjes në mënyrë që ti japim asaj stilin që dëshirojmë, duhet që këtë përmbajtje ta vendosim brenda një *tag*-u SPAN ose DIV. Në ndryshim nga SPAN, DIV vendos një ndërprerje rreshti në fillim dhe në fund të çdo seksioni duke krijuar në këtë mënyrë blloqe me tekst pa pasur nevoja që ti vendosim ato në *tag*-e të tjera si paragrafi.

4.2 Tipare të tjera te CSS

Disa nga veçorit që shërbejn për të përcaktuar pamjen e tekstit janë: • **font-family**: lloje shkrimi sic mund të jenë: serif, cursive, sans-serif, fantasy apo monospace. Ne mund ti caktojmë tekstit një lloj shkrimi ose disa duke i ndarë ato me presje nga njëra tjetra. Duhet pasur kujdes që fontet që ne do të përcaktojm të jenë të instaluara në kompjuter.

• **font-size**:madhësia e fontit. xx-small, x-small, small, medium, large, x-large, xx-large si dhe vlera numerike.

• **font-style**: stili i fontit. Mund të përdoret normal, italic, italic small caps, oblique, oblique small caps dhe small caps.

Veçoritë e mëposhtme përdoren në blloqet e teksteve sic mund të jenë paragrafët.

•margin-top, margin-right, margin-bottom, margin-left: distanca minimale ndërmjet një blloku dhe elementit ngjitur.

•padding-top, padding-right, padding-bottom, padding-left: mbush në hapësirën në mes të kufirit dhe përmbajtjen e bllokut.

border-top-width, border-right-width, border-bottom-width, border-left-width: gjerësia e konturit të bllokut në vlera numerike.
border-style: stili i konturit të bllokut. none, solid ose 3D.

• **border-color**:ngjyra e konturit.

4.3 Trashëgimia

Është një ndër cilësitë më të fuqishme të CSS dhe ka domethënien se njëherë që kemi specifikuar një property për një element kjo property do të trashegohet dhe tek elementët të cilët janë fëmijë të elementit të mëlartmë që ka të specifikuar cilësine në fjalë. Për shembull nqs kemi specifikuar propertinë font-family për elementin
body> ath këtë property do ta trashëgojnë të gjithë elementët që përmbahen tek body I faqes. Kjo cilësi është mjaft lehtësuese për kodin tuaj meqenëse nuk ju duhet ta ripërcaktoni në cdo element të faqes porse vetëm në një element "prind".

Por duhet të bëni kujdes! Nëse një property cilësohet në mënyrë të veçantë për një element atëherë atributi i trashëguar prej elementit prind do të bëhen overwrite me propertinë e cilësuar në nivel të atij elementi. Në shembullin tonë të parë pamë se tipi I fontit I përcaktuar në nivel elementi
body> ishte arial. Porse kishte disa qeliza të vecanta të tabelës që përdornin tipin e fontit Courrier. Këto qeliza ishin qelizat të cilat kishin të shoqëruar rregullat e class-es code. Pra edhe pse këto qeliza duke qenë "fëmijë" të elementi
body> trashëgojne cilësine e tipit të fontit Arial prej "prindit" të tyre; arrijnë

të mbishkruajmë këtë cilësi me cilësine e Courrier e cila përcaktohet në nivel elementi tek classa code. Kjo ndodh sepse selektuese duke qenë specifikisht I përcaktuar për td.class është në gjendje të paraprij atributet e vendosura në nivel më të lartë hierarkie.

Galeritë e Imazheve me CSS

CSS mund të përdoret edhe për të krijuar galeri imazhesh. Më poshtë është paraqitur kodi për një galeri imazhi. Galeria përmban tre imazhe të emërtuara image1, image2, image3 dhe të ruajtuar në dosjen me emrin image.

```
<html>
<head>
<style>
#gallerywrapper{
     float:left;
     position:relative;
     z-index:5;
}
.gallerydisplay {
     padding:0;
     margin:0px 0 0 0;
     list-style-type:none;
     float:left;
.gallerydisplay img.mainimage,
#defaultimage img.mainimage{
     border:0;
     width:100px;
     height:100px;
}
.gallerydisplay li {
     float:left;
     margin:10px 0 10px 0;
```

```
.gallerydisplay li a img.mainimage
     { position:absolute;
     left:0;
     display:none;
     border:0;
     top:55px;
     z-index:5;
}
.gallerydisplay li a:active
img.mainimage, .gallerydisplay li a:hover
img.mainimage, .gallerydisplay li a:focus
img.mainimage {
     display:block;
.gallerydisplay li img.thumbnail{
     height:27px;
     width:27px;
     margin-right:4px;
     border:1px solid #666;
}
.gallerydisplay li a:active
     img.thumbnail{ border:#eee solid
     1px;
}
#defaultimage img{
     position:absolute;
     top:55px;
     left:0;
     z-index:-1;
</style>
</head>
<body>
<div id="gallerywrapper">
     <div id="defaultimage">
          <img class="mainimage"
src="images/image1.jpg" title="Image 1"
alt="Image
1" />
                          37
```

```
</div>
    <a href="#">
                  <img class="thumbnail"
src="images/image1.jpg" title="Image 1"
alt="Image 1" />
                  <img class="mainimage"
src="images/image1.jpg" title="Image 1"
alt="Image 1" />
              </a>
         <1i>
              <a href="#">
                   <img class="thumbnail"
src="images/image2.jpg" title="Image 2"
alt="Image 2" />
                  <img class="mainimage"
src="images/image2.jpg" title="Image 2"
alt="Image 2" />
              </a>
         <1i>
              <a href="#">
                   <img class="thumbnail"
src="images/image3.jpg" title="Image 3"
alt="Image 3" />
                  <img class="mainimage"
src="images/image3.jpg" title="Image 3"
alt="Image 3" />
              </a>
         </div>
</body>
</html>
```